



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



OJQ-Shoqata për Përparimin e Mediave „Shadërvan“

Pronar – OJQ- „Shadërvan“

Radio Prizreni

Rr/ Jusuf Gervalla/LAMC/nr OCK11/12

Prizren

Ref:1609/984/KPM/am

VENDIM

për mos ripërtëritjen e licencës së transmetimit të Radio Prizreni, me seli në Prizren

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio Prizreni është subjekt transmetues me mbulueshmëri lokale, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e radio programeve në Komunën e Prizrenit, me seli në Prizren, në regjionin e Prizrenit. KPM, me datën 28 gusht 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës afatgjatë për Radio Prizreni.
3. Me datën 28 gusht 2016, afati i licencës së Radio Prizreni ka skaduar, ndërsa, në bazë të nenit 25 të Ligjit për KPM-në, kandidati ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës nga Zyra Ekzekutive brenda gjashtë (6) muajve para skadimit të datës së licencës ekzistuese dhe minimum gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të licencës.
4. Më datën 11 maj 2016, Departamenti i Licencimit, pranë Zyrës Ekzekutive të KPM-së, e ka njoftuar të licencuarin lidhur me obligimet që parashihen me nenin 25, duke e njoftuar kandidatin që të bëjë kërkesën për vazhdim të licencës, brenda afateve të përcaktuara me këtë nen.

5. Njoftime të ngjashme me shkrim janë ridërguar tek Radio Prizreni edhe më 28 qershor 2016 dhe më 10 gusht 2016, me qëllim të nxitjes së kandidatit në fjalë për të vepruar në pajtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së.
6. Radio Prizreni me datën 10 qershor 2016 ka parashtruar kërkesën me shkrim në KPM, për të shprehur interesimin e tij për ripërtëritje të licencës.
7. Radio Prizreni nuk ka arritur t'i shlyej obligimet ndaj tarifës së KPM-së, për vitin 2014 edhe përkundër shkresave, takimeve si dhe njoftimeve për shkelje, të dërguara nga KPM.

Arsyetimi

8. Radio Prizreni ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 të Ligjit të KPM-së, duke mos shlyer obligimet ndaj tarifës për licencë për vitin 2014.
9. Vendimi KPM-së (**KPM V1-2016**), i datës 8 shtator 2016, thekson se KPM nuk do të marrë për bazë asnjë kërkesë të kandidatëve të cilët nuk i kanë shlyer obligimet ndaj tarifës për licencë të KPM-së.
10. Duke marrë parasysh se Radio Prizreni, nuk ka vepruar në pajtim me udhëzimet e KPM-së dhe në kundërshtim me nenin 25 dhe nenin 26 të Ligjit për KPM-në, KPM konstaton se ka bazë të mjaftueshme për mos ripërtëritjen e licencës së transmetimit për Radio Prizreni.

VENDIM

11. Komisioni merr vendim për mos ripërtëritje të licencës së Radio Prizreni, ndërsa, procedurat për shlyerjen e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, mbetet të zbatohen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.
12. Udhëzohet Radio Prizreni që të ndërpresë menjëherë veprimtarinë për ofrimin e shërbimeve audio (radio) dhe se frekuenca 88.4 MHz konsiderohet e lirë dhe nën menaxhimin e KPM-së.
13. Dështimi për të zbatuar këtë vendim, që nga hyrja e tij në fuqi, do të rezultojë me masat ligjore të cilat mund të qonjë deri në konfiskimin e pajisjeve.

E drejta për Ankesë

14. Në bazë të Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave (Ligji nr. 04/L-44), palës i njihet e drejta e ushtrimit të ankesës ndaj këtij vendimi.

15. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
16. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysht vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.

Lëshimi i Vendimit

17. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij.

Adnan MEROVCI
KRYETAR
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



19.09.2016
datë